



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
FUSHË - KRUE

na Post: 506

03/06/2025

PLANI I INTEGRITETIT

PËR QENDRËN E TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUE
PËR VITET 2025-2027



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
FUSHË - KRUJË

PLANI I INTEGRITETIT

PËR QENDRËN E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË PËR VITET 2025-2027

Grupi i punës:

Vilka LALA

Shpresa DEMIRXHIU

Adri KODRA

MIRATOI

TITULLARI

Ilir SALILLARI



TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	3
1. PLANI I INTEGRITETIT, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT.....	4
1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit	4
1.2 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit	4-5
1.3 Metodologjia.	5
2. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE	6-9
3. PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRITETIN	9-15

LISTA E SHKURTESAVE

QTTB Fushë-Krujë - Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë

PI - Plan Integriteti

BNJ - Burime Njerëzore

DAP - Departamenti i Administratës Publike

MVRK - Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

PT - Programi i Transparencës

1. PLANI I INTEGRITETIT, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Plan i Integritetit të QTTB Fushë-Krujë, është konceptuar dhe bazuar në Strategjinë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe në Planin e Veprimit 2024-2026, sipas Objektivit Specifik 1.2: “Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes”.

Plan i Integritetit për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë, u hartua gjatë periudhës Prill 2025 - Maj 2025. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore.

Qëllimi i Planit të Integritetit është:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e QTTB Fushë-Krujë për të kryer funksionin në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme;
- Studimi i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara;
- Formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Objektivat e Planit të Integritetit për vitet 2025-2027 të QTTB Fushë Krujë:

- **Objektivi 1:** Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në QTTB Fushë-Krujë, në mënyrë që të minimizohet çënimin e tyre nga risqet e integritetit;
- **Objektivi 2:** Realizimi në kohë dhe me cilësi të programeve, projekteve problemore, projekteve të kërkimit në fermë, ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve të Bazës Eksperimentale dhe Prodhuese;
- **Objektivi 3:** Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit;
- **Objektivi 4:** Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së QTTB Fushë Krujë brenda institucionit, me aktorë e jashtëm të interesuar dhe publikun.

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Menaxhimi i riskut të integritetit në QTTB Fushë-Krujë përfshin zbatimin e 6 fazave të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën si mëposhtë:

- Vlerësimi i risqeve;
- Identifikimi i risqeve;
- Vlerësimi i risqeve;
- Trajtimi i risqeve;
- Plan i veprimit për menaxhimin e riskut dhe regjistri i riskut;
- Monitorimi dhe raportimi.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të institucionit. Këto fusha përfshijnë:

1. Fushën e menaxhimit financiar;
2. Fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
3. Fushën e programeve dhe projekteve që lidhen me bujqësinë;
4. Fushën e kontrollit, auditimit dhe e mekanizmave kundër korrupsionit;
5. Fushën e transparencës;
6. Fushën e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve shkresore, si dhe të informacionit e të dokumenteve elektronike;
7. Fushën e politikave dhe strategjive në fushën e bujqësisë;
8. Fushën e hartimit dhe vlerësimit të legjislacionit.

1.2 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në QTTB Fushë-Krujë konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1.2.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizua stafit të QTTB Fushë-Krujë

Titullari i institucionit ngriti grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e planit të integritetit të QTTB Fushë-Krujë. Në përbërje të grupit të punës ishin punonjës të QTTB Fushë-Krujë të nivelit drejtues. Grupi i punës u kryesua nga një koordinatore, e cila siguroi mbështetjen e procesit dhe koordinimin e aktiviteteve në institucion.

1.2.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Kjo fazë përfshiu dhe analizën e raporteve të ndryshme të QTTB Fushë-Krujë mbi veprimtarinë e saj por dhe të jashtme mbi çështje që lidhen me fushat e veprimtarisë së institucionit. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të QTTB Fushë-Krujë. Grupi u punës administroi një anketim me stafin e QTTB Fushë-Krujë, për të matur perceptimet e tyre mbi çështje të integritetit dhe etikës në institucion si edhe për të vlerësuar ndikimin e tyre mbi kuadrin rregullator dhe struktural për integritetin në institucion.

1.2.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit

Gjatë kësaj faze, grupi i punës vlerësoi intensitetin e risqeve të analizuara në fazën e mësipërme. Grupi i punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të pritët të mbështesin ose rrisin risqet në tilla. Gjatë kësaj faze të procesit u krye edhe një analizë për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim risqet e vlerësuar dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi

vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre. Në këtë fazë të procesit kontribuan gjithashtu diskutimet dhe feedback-u i marrë nga fokus grupet me stafin e drejtorive të ndryshme të institucionit.

1.2.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre. Kostot financiare të këtij Plani do të mbulohen nga buxheti i QTTB Fushë-Krujë.

1.3 Metodologjia

Metodologjia është e mbështetur në disa parime kryesore, zbatimin e të cilave ndikon në përmirësimin e shkeljeve që çenojnë integritetin e institucionit. Këto parime përfshijnë:

- Minimizimin e pushtetit diskrecional të tepërt dhe të panevojshëm që zotërojnë autoritetet ekzekutive, administrata apo organet/strukturat në marrjen e një vendimi, dhe/ose qartësimin e përcaktimit të kriterëve, procedurave dhe standardeve për procesin e vendimmarrjes;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike në punën e institucionit, gjë që minimizon risqet që dëmtojnë integritetin e institucionit dhe është garanci për zbatimin e parimit të ligjshmërisë;
- Forcimin e mekanizmave të kontrollit për institucionin. Në parim, çdo veprim i autoritetit publik duhet të jetë objekt kontrolli për të ruajtur sistemin "kontrollo balancën" dhe parimin e ndarjes së pushteteve;
- Thjeshtëzimin dhe riorganizimin e procedurave të zbatuara nga autoritetet, organet apo administrata qendrore të cilat nuk përmbushin qëllimin për të cilin janë miratuar dhe krijojnë mundësi për risqe integriteti.

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në institucionin e QTTB Fushë-Krujë u përdorën dy metoda:

- **Metoda cilësore**, përmes zhvillimit të një trajnimi orientues për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit me grupin e punës së ngritur dhe stafin e QTTB Fushë-Krujë si dhe 2 takimeve të fokusuara me stafin e QTTB-së.

Takimet e fokusuara shërbyen:

- Për të identifikuar proceset e punës në fusha të veprimtarisë së institucionit të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit;

- Për të identifikuar sjelljet joetike e joprofesionale dhe parregullsive të tjera;
- Për të vlerësuar risqet e integritetit dhe faktorët e tyre në kuadër të këtyre proceseve.

Procesi u shoqërua edhe më një analizë të kuadrit të brendshëm rregullator të QTTB Fushë-Krujë (shqyrtim literature), i cili përfshin: urdhra, manuale, rregullore dhe akte të brendshme. Gjithashtu, u hulumtuan raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e QTTB Fushë-Krujë si, p.sh.: raporte të auditit të brendshëm, raporte monitorimi, raporte vjetore, matrica e riskut financiar etj.

- **Metoda sasiore**, përmes vlerësimit me anë të një ankete të strukturuar, ku punonjësit e QTTB Fushë-Krujë u përgjigjën pyetjeve mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Anketimi përfshiu një kampion me 61 punonjës të institucionit me nivel besueshmërie statistikore 95%, shkalla e vlerësuar e gabimit është +/- 2%. Për të krijuar një larmishmëri më të madhe në analizë, kampionimi përfshiu një shpërndarje më të gjerë në lidhje me gjininë, moshën dhe vjetërsinë në punë. Pyetësorët e strukturuar u plotësuan në mënyrë anonime nga stafi i QTTB Fushë-Krujë.

1.3.1 Përmbajtja e Planit të Integritetit

Plani i QTTB Fushë-Krujë është një instrument i luftës kundër korrupsionit, për të patur një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe e angazhuar për t'iu shërbyer qytetarëve në fushën e bujqësisë, blegtorisë të tjerë sektorë nën përgjegjësinë e QTTB Fushë-Krujë. Ky plan ka të parashikuar masa të identifikuara në 8 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë.

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet si më poshtë:

- **Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të QTTB Fushë-Krujë**, përshkrimi i fazave të procesit të planifikimit të integritetit dhe qasja metodologjike;
- **Risqet integritetit dhe faktorët e tyre** – i cili përfshin një përshkrim të risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre në fushat e përgjegjësisë së institucionit.
- **Plani i Veprimit** – i cili përmban masat e kontrollit që duhet të ndërmerren për të adresuar risqet e identifikuara dhe të vlerësuara.

Plani i është vënë në dispozicion të gjithë stafit të QTTB Fushë-Krujë dhe grupeve të interesit, për të qenë një instrument efektiv që orienton punët e përditshme drejt interesit publik, standardeve të larta profesionale dhe performancës së mirë institucionale.

II. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion është paraqitur një përshkrim i përmblodhur i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të analizuar sipas fushave të veprimtarisë së QTTB Fushë-Krujë dhe të kategorizuara si më poshtë:

2.1 Risqe dhe faktorë të risqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm rregullator dhe institucional për integritetin

QTTB Fushë-Krujë është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe funksionon sipas Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë" të miratuar nga Ministri, ku përcaktohen qartë objektivat, prioritet strategjike të institucionit. Rregullorja mban nr. 748 Prot. datë 18.11.2020 dhe është përditësuar dhe e miratuar në MBZHR. Në këtë rregullore janë përfshirë edhe detyra në zbatim të Ligjit nr. 9131 datë 8.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike".

Punonjësit janë njohur me ligjet dhe rregulloren e brendshme duke organizuar takime me punonjësit. Çdo fillim jave organizohet takimi i Titullarit me drejtuesit e Drejtorive/Sektorëve, të cilët, informacionet e reja jua komunikojnë stafit që kanë në varësi.

QTTB Fushë-Krujë ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të institucionit. Baza ligjore për etikën ku jemi bazuar është ligji nr. 9131 datë 8.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" dhe pjesa për etikën tek rregullorja e brendshme. Kjo rregullore përmban ndër të tjera: përfshirjen e funksioneve/njësive që rrjedhin nga ligje të tjera, si ai për të drejtën e informimit apo njoftimit dhe konsultimit publik; njësisë së sinjalizimit apo konfliktit të interesit; përcaktimin e linjave të qarta të komunikimit dhe raportimit ndërmjet drejtorive të ndryshme; parashikimin e rregullave për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale etj.

QTTB Fushë-Krujë ka miratuar rregulla të brendshme për funksionimin dhe administrimin e regjistrit të dhuratave në institucion, si dhe për deklarimin, origjinën dhe kontrollin e dhuratave të marra nga punonjësit e institucionit. Gjithashtu rezulton të jetë në funksion një regjistër i dhuratave. Pranë sektorit të burimeve njerëzore të institucionit duhet ngritur njësia e parandalimit të konfliktit të interesit. Kjo njësi duhet të hapë regjistrin e konfliktit të interesit dhe të regjistrojë praktikën në përmbajtje të tij. Çdo individ apo subjekt ka të drejtën e ankesës në institucion nëse ka probleme të tilla, protokollohen ankesat nëse ka dhe adresohen për zgjidhje. Baza ligjore është ligji nr. 9367 datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Institucioni ka ngritur njësinë përkatëse në institucion për çeshtjet që lidhen me integritetin duke kryer një vlerësim dhe raportim periodik në lidhje me zbatimin e Planit të Integritetit.

2.2 Risqe dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)

Mirëfunksionimi i administratës ka nevojë për linja të qarta hierarkike, manual të proceseve të punës për çdo njësi të institucionit ndryshe Procedura Standarde Veprimi (PSV) si dhe për përmirësimin dhe përqafimin e standardeve dhe parimeve të administratës publike. Këto elemente mbështesin një kulturë integriteti për administratën shtetërore.

QTTB Fushë-Krujë ka një organikë të miratuar me 61 punonjës nga të cilët 17 prej tyre janë pozicione vakante. Procedurat e rekrutimit kryhen nga DAP për nëpunësit civil dhe me kod pune për punonjësit me kontratë. Fillimisht institucioni dërgon kriteret për të përcaktuar kandidatet që i përshkruajnë nevojat e institucionit tek DAP si dhe në rastet e lëvizjes paralele ose të ngritjes në detyrë duke vendosur në komision edhe drejtues nga institucioni. Nga vlerësimi i situatës rezulton mungesë në staf në pozicionet e nivelit drejtues të lartë, të mesëm, si edhe atyre të kategorisë ekzekutive në njësitë përbërëse të QTTB Fushë-Krujë. Pozicione pune të cilat për nga natyra e punës paraqesin nevoja për burime të kualifikuara si në përvojë ashtu edhe në kualifikime profesionale dhe që kërkojnë personel të përhershëm, mbulohen në disa raste me kontrata pune afatshkurtra me studentë ekselentë. Mosplotësimi i tyre me staf të përhershëm rëndon efektivitetin e proceseve të punës. Një komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit të burimeve njerëzore në institucion është trajnimi i vazhdueshëm i tyre. Mundësitë e trajnimit të personelit ofrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në MBZHR dhe ASPA ku na ofrohen mundësi trajnimi për çështje të ndryshme për rritur aftësinë profesionale të punonjësve në përputhje me objektivat e institucionit.

Nga vlerësimi i situatës dhe indikatorëve të këtij komponenti rezulton se institucioni ka miratuar një plan vjetor të trajnimeve për punonjësit, por ka mungesë në:

- Parashikimin e sistemit të analizës në lidhje me nevojat për trajnim, me qëllim përcaktimin e nevojave reale të punonjësve për trajnime;
- Përcaktimin e procedurës së raportimit dhe shkëmbimit të informacionit në lidhje me pjesëmarrjen e stafit në trajnime, duke bashkëndarë njohuritë e fituara me kolegët e tjerë, me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive apo të shkëmbimit të përvojave nga praktika;
- Përcaktimin e një sistemi feedback-u për të mundësuar vlerësimin e trajnimeve.

Punonjësit e QTTB Fushë-Krujë, gjatë procesit të identifikimit të problematikave që lidhen me kapacitetet profesionale në fushat funksionale, evidentuan nevoja të dukshme për trajnime të specializuara sipas specifikave të sektorit ku ata punojnë.

Dëna nga sfidat që identifikohen në institucion në çështjen e zhvillimit të burimeve njerëzore janë:

- Kapacitete njerëzore të pamjaftueshme dhe të kufizuara teknike në shumicën e proceseve të punës.
- Infrastrukturë fizike dhe pajisje të pamjaftueshme.
- Institucioni yne nuk ka një program të mirëfilltë dedikuar trajnimit për integrim dhe sjellje etike por gjithmonë zbatojmë rregulloren, udhëzimet që dalin në lidhje me këto çështje dhe ndjekim trajnimet e ASPA-s për çështje të tilla.

2.3 Riske dhe faktorët e risqeve për transparencën e punës dhe e veprimtarisë së QTTB Fushë Krujë brenda institucionit, me aktorë e jashtëm të interesuar dhe publikun

Nga analiza përmbajtjesore e faqes zyrtare të internetit të QTTB -së, vihet re se publikohen të dhëna dhe informacione me karakter informues. Nuk janë të publikuara informacione dhe dokumente që lidhen me mekanizmat monitorues, të kontrollit dhe llogaridhënës, siç mund të jenë: raporte të ndryshme monitorimi të kontrollit të brendshëm, kontrata, raporti vjetor i transparencës etj. Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit kërkon jo vetëm staf të informuar dhe më aftësitë e duhura, por edhe komunikim efektiv që respekton afatet kohore në sigurimin e informacionit. QTTB Fushë Krujë nuk ka një sistem të TI dhe ka nevojë për një specialist të TI në organikë, që të jetë i angazhuar vazhdimisht me këtë proces.

Programi i Transparencës (PT) përfaqëson një instrument që kontribuon për transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucionit, një detyrim i përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e së drejtës për informim. Nga të dhënat e anketimit 90% e punonjësve të QTTB-së raportojnë se informimin e publikut mbi aktivitetet e institucionit e realizojnë përmes faqes zyrtare të internetit të QTTB-së.

III. PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRITETIN

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë të QTTB-së. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

PI ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si mëposhtë:

1. Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në QTTB Fushë Krujë në mënyrë që të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integritetit;
2. Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit;
3. Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së QTTB Fushë Krujë brenda institucionit, me aktorë jashtëm të interesuar dhe publikun.

2.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Integritetit

Monitorimi është periodik dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në PI. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për progresin e zbatimit.

Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

2.2 Objektivat për forcimin e integritetit në QTTB Fushë Krujë për vitet 2025-2027:

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në QTTB Fushë-Krujë, në mënyrë që të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integritetit.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë, i moderuar, i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati
1	Kuadri rregullator për etikën dhe integritetin i paplotë: 1. Në rregulloren e brendshme janë përfshirë detyrat në zbatim të Ligjit nr. 9131 datë 8.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike" por nuk nuk parashikohen rregulla të plota për aspekte të veçanta të integritetit.	Përputhshmërie dhe Reputacional	I moderuar	Hartimi, miratimi i Kodit të Etikës dhe publikimi i tij në faqen zyrtare të institucionit.	Grupi i Punës për hartimin e Rregullave të Etikës dhe Integritetit. Afati, gjashtëmujori i dytë i vitit 2025.

Objektivi 2: Realizimi i programeve, projekteve problemore, projekteve të kërkimit në fermë, ofrimit të shërbimeve dhe aktiviteteve të Bazës Eksperimentale dhe prodhuese.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë, i moderuar, i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati
1	Personel i pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar procese të rëndësishme të punës, gjë që sjell mbivendosje të personelit në shumë detyra.	Përputhshmërie	I lartë	Raportim periodik në MBZhR për plotësimin vendeve vakante.	Spektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse QTTB Fushë Krujë, Drejtoria BNJ në MBZhR. Afati: vitet 2025-2027
2	Vonesat në procedurat e prokurimit.	Operacional	I lartë	Ndjekja e afateve të procedimit sipas legjislacionit.	Spektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse QTTB Fushë Krujë Afati: vitet 2025-2027
3	Vonesat në miratimin e projekteve problemore nga MBZhR sjell vështirësi në realizimin në kohë dhe me cilësi të projekteve.	Përputhshmërie	I moderuar	Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me MBZHR.	Spektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse QTTB Fushë Krujë Afati: vitet 2025-2027

Objektivi 3: Burime njerëzore adekuatë, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit.

Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë, i moderuar, i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati
1. Organika e miratuar për Burimet Njerëzore nuk është plotësuar (janë 17 pozicione vakante në institucion). 2. Lidhja e kontratave të përkohshme të punës me studentë ekselentë, për vendet e shpallura me shërbimin civil; 3. Mosparashikimi në rregulloren e institucionit të procedurës së zëvendësimit për një pozicion pune vakant, si edhe zëvendësuesit për secilin pozicion.	Operacional	I lartë	1. Raportim periodik në MBZhR për plotësimin vendeve vakante. 2. Dërgimi periodik i kriterëve për të përcaktuar kandidatet që i përshtatet nevojave të institucionit tek DAP. 3. Plotësimi me personel të përhershëm për të gjitha drejtoritë. 4. Parashikimi në rregulloren e brendshme të institucionit i procedurës së zëvendësimit për një pozicion vakant.	Spektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse QTTB Fushë Krujë, Drejtoria BNJ në MBZhR. Afati: vitet 2025-2027
1. Mungesa e buxhetit të dedikuar për trajnimin e stafit dhe moskryerja e analizës së nevojave për trajnimet (training needs assessment). 2. Mosfunksionimi i sistemit të vlerësimit mbi ndikimin e trajnimeve.	Financiar dhe Operacional	Mesatar	1. Përfshirja, në rregulloren e brendshme të institucionit, e detyrimit për kryerjen e analizës vjetore të nevojave për trajnim si brenda dhe jashtë vendit, si dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve. 2. Parashikimi në planin financiar i një buxheti të dedikuar për trajnimin e stafit.	Spektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse QTTB Fushë Krujë, Drejtoria e BNJ në MBZhR, ASPA. Afati: vitet 2025-2027

Objektivi 4: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së QTTB Fushë Krujë brenda institucionit, me aktorë e jashtëm të interesuar dhe publikun.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati
1	1. Raportet e kontrollit të jashtëm apo të auditimit të brendshëm për veprimtarinë e QTTB nuk janë publikuar në faqen zyrtare të internetit faqen zyrtare të internetit. 2. Procedura për të bërë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe sinjalizime në QTTB nuk është publikuar në faqen zyrtare të internetit. 3. Rregullorja e brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit nuk është publikuar faqen zyrtare të internetit. 4. Informacioni për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (e punëve publike, mallrave, shërbimeve) nuk është publikuar faqen zyrtare të internetit. 5. Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit publik nuk është publikuar në faqen zyrtare të internetit.	Operacionale	Mesatar	1. Rekrutimi i një specialist/eksperti të TI për publikimet në faqen zyrtare të internetit; 2. Publikimi i raporteve të kontrollit të jashtëm apo të auditimit të brendshëm; 3. Publikimi i raporteve të monitorimit financiar; 4. Publikim i procedurës për të bërë kërkesa, ankesa, vërejtje dhe sinjalizime në institucion; 5. Publikimi i rregullores e brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit; 6. Publikimi i regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik në faqen zyrtare të internetit.	Sektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse QTTB Fushë Krujë. Afati: vitet 2025-2027